

KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
për fëmijë



Tiranë, 2024

Titulli: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për Fëmijë

Ilustrimet: Ilustrimet e këtij botimi janë kontribut i nxënësve pjesëmarrës në programin 'Punishtja e Demokracisë' e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Kopertina: Luena Dushku

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
©Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2024



Preambula

Ne, shqiptarët, jemi krenarë për historinë tonë dhe kujdesemi për të ardhmen. Ne besojmë te Zoti dhe te vlera që na bëjnë qyetarë më të mirë. Duam të ndërtojmë një shtet ku ligjet janë të drejta për të gjithë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe ku njerëzit jetojnë të lirë.

Duhet të jetojmë në paqe me njëri-tjetrin, pavarësisht se cilës fe i përkasim, dhe të respektojmë dinjitetin e çdo personi.



Duam që Shqipëria të jetë një vend ku të gjithë të kenë një jetë të mirë, me kulturë, mirëqenie dhe solidaritet.

Ne gjithashtu ëndërrojmë që populli shqiptar të ruajë identitetin e tij të veçantë dhe të qëndrojë i bashkuar. Besojmë fort se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi mes vendeve janë vlera të rëndësishme për të gjithë.



PJESA E PARË: PARIME THEMELORE

Forma e shtetit dhe qeverisjes

Shqipëria është një Republikë Parlamentare ku qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre për të bërë ligjet dhe për të qeverisur shtetin.

Është një vend që nuk mund të ndahet. Ajo është e bashkuar dhe kështu do të mbetet.

Qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre nëpërmjet zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe të rregullta.



Shqipëria dhe populli shqiptar

Në Shqipëri, fuqia për të vendosur i përket qytetarëve. Ata vendosin për vendin nëpërmjet përfaqësuesve që zgjedhin, deputetët.

Shqipëria është një vend i pavarur dhe gjithmonë do të mbetet i bashkuar. Ajo mbron paqen, lirinë, të drejtat dhe dinjitetin e çdo personi, duke siguruar drejtësi për të gjithë. Shqiptarët dhe të gjitha pakicat që jetojnë në Shqipëri, pavarësisht besimit apo prejardhjes së tyre, jetojnë së bashku në harmoni dhe mirëkuptim. Shteti i respekton dhe i mbron këto vlera dhe të drejta.



Kushtetuta dhe ligjet

Kushtetuta është ligji më i lartë dhe duhet të respektohet nga të gjithë. Ligjet e drejta janë baza e shtetit shqiptar. Shqipëria respekton dhe ndjek rregullat ndërkombëtare që ka pranuar.

Shteti dhe institucionet

Pushteti në Shqipëri ndahet në tre: ata që bëjnë ligjet (ligjvënësit), ata që zbatojnë ligjet (qeveria) dhe ata që kujdesen për drejtësinë (gjyqësori). Të gjitha institucionet funksionojnë sipas ligjeve dhe rregullave.



Shqiptarët jashtë vendit

Shqipëria kujdeset për të drejtat e shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit dhe i ndihmon që të ruajnë lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

Partitë politike

Qytetarët mund të krijojnë parti politike dhe këto parti duhet të respektojnë rregullat e demokracisë. Partitë që përhapin urrejtje ose përdorin dhunë janë të ndaluara në Shqipëri.



Ekonomia dhe prona

Ekonomia bazohet në pronë private dhe publike. Shqipëria ka një ekonomi që bazohet mbi pronën private dhe publike dhe qytetarët kanë liri në aktivitetet e tyre ekonomike.

Feja dhe shteti

Shteti nuk ka fe zyrtare. Gjithkush është i lirë të ndjekë cilën fe dëshiron. Shteti nuk preferon asnjë fe dhe respekton të gjitha besimet.



Forcat e armatosura


Ushtria e Shqipërisë mbron pavarësinë e vendit dhe siguron që kufijtë e tij të mbeten të paprekur. Ushtria nuk merr pjesë në politikë dhe i bindet gjithmonë drejtuesve. Asnjë ushtri e huaj nuk mund të hyjë në Shqipëri dhe as ushtria shqiptare nuk mund të shkojë jashtë vendit.

Qeverisja vendore

Shqipëria ndjek parimin e autonomisë për qeverisjen vendore, ku bashkitë dhe njësitë administrative marrin vendime për çështjet e tyre.

Simbolet Kombëtare

Gjuha zyrtare e Shqipërisë është gjuha shqipe. Flamuri kombëtar është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Stema përmban shqiponjën dhe përkrenaren e Skënderbeut.



Himni kombëtar është “Rreth Flamurit të Përbashkuar” dhe festa kombëtare është Dita e Flamurit më 28 Nëntor.

Kryeqyteti i Shqipërisë është Tirana.



PJESA E DYTË: TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

Të drejtat dhe liritë

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë shumë të rëndësishme dhe askush nuk mund t'i ndryshojë apo t'i kufizojë ato. Janë baza e të drejtës në Shqipëri. Shteti dhe institucionet duhet të respektojnë dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e tyre.


Të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm për një arsye shumë të rëndësishme e të mirë, si mbrojtja e të tjerëve ose e interesit publik. Kufizimet duhet të jenë të drejta dhe nuk mund të shkojnë më tej se kufizimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.


LUFTË PAQËSORE
PËR
TË
DREJTA
TË
BARABARTA

Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejta të barabarta me të gjithë të tjerët dhe mund të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre pa asnjë pengesë.

Të drejtat dhe detyrimet në Kushtetutë vlejnë për të gjithë, për shqiptarët dhe për të huajt që jetojnë në Shqipëri.

Çdo person që ka një prind shqiptar fiton automatikisht shtetësinë shqiptare. Askush nuk mund të humbasë shtetësinë shqiptare nëse nuk e dorëzon vetë.



Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Askush nuk mund të trajtohet ndryshe për shkak të gjinisë, racës, fesë, gjuhës ose prejardhjes.

Barazi



Liritë dhe të drejtat vetjake

E drejta e jetës për çdo person
është e mbrojtur me ligj.

Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së shprehjes. Askush nuk mund të censurojë mendimet e të tjerëve.



Të gjithë kanë të drejtë të informohen për punën e institucioneve shtetërore dhe vendimet që merren.

Çdokush është i lirë të ndjekë ose të ndryshojë fenë që dëshiron dhe ta praktikojë atë lirisht.



Askush nuk mund të torturohet apo të trajtohet në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese.

Askush nuk mund të arrestohet ose burgoset pa arsye të ligjshme. Çdokush që arrestohet duhet të njoftohet për arsyen dhe të ketë mundësinë të flasë me një avokat.

Të gjithë kanë të drejtë të dëgjohen dhe të mbrohen në gjyq dhe nuk mund të dënohen dy herë për të njëjtën vepër penale.





Liritë dhe të drejtat politike

Çdo qytetar shqiptar që ka mbushur 18 vjeç ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet.

Të gjithë kanë të drejtë të organizojnë dhe të marrin pjesë në tubime paqësore.



Avokati i Popullit mbron të drejtat e qytetarëve nga shkeljet e institucioneve publike. Ai është i pavarur dhe zgjedhjet e tij nuk ndikohen nga politika.

Të gjithë kanë të drejtë të krijojnë shoqata dhe organizata për qëllime të ligjshme.



Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Çdo qytetar ka të drejtë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës dhe të fitojë jetesën me punë të ligjshme.

Çdo qytetar ka të drejtë për sigurime shoqërore në rast pleqërie ose paaftësie për punë.



Çdo qytetar ka të drejtë të arsimohet. Arsimi 9-vjeçar është i detyrueshëm dhe është pa pagesë në shkollat publike.



Çdo qytetar ka të drejtë për kujdes shëndetësor dhe sigurime shëndetësore të mbrojtura nga shteti.



PJESA E TRETË: KUVENDI

Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, përfaqëson qytetarët, miraton ligjet dhe kontrollon qeverinë. Deputetët janë përgjegjës për të bërë ligje dhe për të diskutuar për çështje të rëndësishme për vendin. Ata zgjidhen përmes zgjedhjeve dhe votës së qytetarëve. Zgjedhjet për Kuvendin bëhen çdo katër vjet.



Deputetët

Deputetët zgjidhen nga partitë politike ose nga qytetarët që duan të kandidojnë. Ata përfaqësojnë popullin dhe kanë detyrën të mbrojnë interesat e qytetarëve, duke diskutuar dhe duke miratuar ligje.

Nuk mund të bëhesh deputet nëse je gjyqtar, ushtarak, polic, përfaqësues diplomatik apo ke një detyrë tjetër të rëndësishme në shtet.



Deputetët betohen në Kuvend para se të fillojnë detyrën e tyre.

Punimet e Kuvendit


Kuvendi punon në dy periudha të vitit, njëra që fillon në janar dhe tjetra në shtator. Kuvendi mund të mblidhet edhe jashtë këtyre periudhave nëse e kërkon Presidenti, Kryeministri ose një pjesë e deputetëve. Gjatë mbledhjeve, Kuvendi zgjedh kryetarin e tij, i cili drejton seancat, siguron që rregullat të respektohen dhe përfaqëson Kuvendin.

Deputetët diskutojnë dhe votojnë për ligjet. Ata formojnë komisione që merren me shqyrtimin e çështjeve të veçanta.




Mbledhjet e Kuvendit zakonisht janë të hapura për publikun, por ndonjëherë ato mund të bëhen me dyer të mbyllura për çështje të posaçme.

Kryeministri dhe ministrat duhet t'u përgjigjen pyetjeve, që deputetët u bëjnë për punët e tyre. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, gjithashtu japin shpjegime për Kuvendin, kur iu kërkohet.




Miratimi i ligjeve


Ligjet mund të propozohen nga Këshilli i Ministrave, deputetët, ose nga një grup prej 20 mijë qytetarësh me të drejtë vote. Disa ligje të rëndësishme, si ato që lidhen me zgjedhjet, shtetësinë dhe funksionimin e institucioneve kryesore, duhet të miratohen nga të paktën tri të pestat e deputetëve.



Ligjet propozohen dhe shqyrtohen nga deputetët në Kuvend. Pas shqyrtimit, ato votohen tri here në komision dhe tri here në seancë plenare: një herë në parim, një herë për secilin nen, dhe pastaj në tërësi. Presidenti ka të drejtë të kthejë një ligj për rishqyrtim një herë, por nëse deputetët e votojnë përsëri, ligji hyn në fuqi.



Ligji bëhet zyrtar pasi botohet në Fletore Zyrtare dhe hyn në fuqi të paktën pas 15 ditësh nga botimi. Në raste urgjente, Kuvendi dhe Presidenti mund të vendosin që një ligj të hyjë menjëherë në fuqi.



PJESA E KATËRT:
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Presidenti është kryetari i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.

Ai duhet të jetë shtetas shqiptar që nga lindja dhe duhet të ketë jetuar në Shqipëri për të paktën 10 vitet e fundit. Presidenti duhet të jetë të paktën 40 vjeç kur zgjidhet.

Presidenti është Komandanti i Përgjithshëm
i Forcave të Armatosura.



Ai nxjerr
dekrete për të
realizuar
detyrat e tij.

Mandati dhe detyrat

Kandidati për President propozohet nga të paktën 20 deputetë. Kuvendi e zgjedh Presidentin me votim të fshehtë, pa debat.

Presidenti zgjidhet për një periudhë prej 5 vjetësh dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë. Gjatë betimit, Presidenti zotohet se do t'i bindet Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, si dhe që do të mbrojë të drejtat e qytetarëve dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike dhe nuk mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike apo të kryejë veprimtari private.

Kompetencat

Presidenti ka disa kompetenca të rëndësishme. Ai mund t'i drejtojë mesazhe Kuvendit, të falë të dënuarit sipas ligjit, dhe të japë ose heqë shtetësinë shqiptare. Ai, gjithashtu jep dekorata dhe gradat më të larta ushtarake, dhe me propozim të Kryeministrit, emëron ambasadorët e Shqipërisë në vendet e huaja, përfaqësuesit në organizata ndërkombëtare si dhe emëron rektorët e universiteteve dhe Kryetarin e Akademisë së Shkencave.

Presidenti cakton datat për zgjedhjet e Kuvendit dhe për referendume.

PJESA E PESTË:
KËSHILLI I MINISTRAVE

Këshilli i Ministrave drejton qeverinë dhe udhëheq shtetin. Përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat. Ata janë përgjegjës për të zbatuar ligjet dhe për të siguruar që vendi të funksionojë si duhet.

Këshilli i Ministrave merr vendime për çështjet e rëndësishme të vendit dhe zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi. Mund të bëjë edhe ligje të përkohshme në raste urgjente, si për shembull kur ndodh diçka e papritur. Megjithatë, këto ligje duhet të miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve, përndryshe ato nuk vlejnë më.

Kryeministri

Kryeministri zgjidhet nga partia ose grupi që ka më shumë deputetë në Kuvend dhe emërohet nga Presidenti.

Kryeministri udhëheq qeverinë. Ai drejton mbledhjet e Këshillit të Ministrave dhe vendos për drejtimet kryesore të politikave të shtetit. Siguron që ligjet të zbatohen dhe merr vendime të rëndësishme për vendin.




Mocioni i Besimit dhe Mocioni i Mosbesimit

Kryeministri mund t'i kërkojë deputetëve të Kuvendit të votojnë për ta mbështetur atë dhe qeverinë. Nëse deputetët nuk e mbështesin, atëherë Presidenti mund të shpërndajë Kuvendin dhe të caktojë zgjedhje të reja.

Deputetët mund të votojnë edhe për ta zëvendësuar Kryeministrin.



Nëse zgjedhin një Kryeministër të ri, Presidenti e dekreton.



Nëpunësit publikë

Nëpunësit publikë punojnë për shtetin. Ata ndihmojnë në zbatimin e ligjeve dhe sigurojnë që gjithçka të funksionojë siç duhet. Ata zgjidhen me anë të konkurseve dhe janë të mbrojtur me ligj, që do të thotë se kanë të drejta të veçanta në punën e tyre.



PJESA E GJASHTË:
QEVERISJA VENDORE

Qeverisja vendore në Shqipëri përfshin bashkitë dhe qarqet. Këto janë njësi që kujdesen për punët vendore, si pastrimi i qyteteve, ndërtimi i shkollave apo rrugëve dhe shërbime të tjera të rëndësishme për qytetarët që jetojnë atje. Për çdo bashki apo qark, ka rregulla të veçanta që përcaktohen me ligj.


Komuna dhe bashkia janë njësitë kryesore të qeverisjes vendore. Ato bëjnë punët e përditshme të qeverisjes nëpër qytete dhe fshatra.

Zgjedhja e përfaqësuesve

Përfaqësuesit e bashkive dhe njësive administrative zgjidhen çdo katër vite nga qytetarët me votim të fshehtë. Çdo qytetar që jeton në atë bashki apo njësi ka të drejtë të votojë për këshillin bashkiak dhe për kryetarin e bashkisë ose njësisë administrative.

Bashkëpunimi

Njësitë e qeverisjes vendore, kanë të drejtë të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën ose të formojnë institucione të përbashkëta për të mbrojtur interesat e tyre. Ato gjithashtu mund të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera dhe të përfaqësohen në organizata ndërkombëtare.


Demokracia
Vote

Qarku

Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore dhe ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave për të gjithë rajonin. Kryetarët e bashkive dhe të njësive administrative bëhen automatikisht anëtarë të këshillit të qarkut, që merr vendime për të gjithë qarkun.

Buxheti

Këto njësi vendore kanë buxhetin e tyre që përdoret për të financuar shërbimet dhe projektet që janë të nevojshme për qytetarët. Ky buxhet krijohet sipas ligjit dhe ndihmon njësitë vendore të kryejnë punët e tyre.

Detyrat dhe të drejtat

Këshillat bashkiakë dhe të njësive kanë shumë detyra, si të rregullojnë çështjet e zonës së tyre dhe të marrin vendime për taksat vendore. Ata, gjithashtu krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si flamujt dhe titujt e nderit për qytetarët që kanë kontribuuar për zonën e tyre.



PJESA E SHTATË:
AKTET NORMATIVE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Akti Normativ

Akti normativ është një rregull që shteti e vendos për të rregulluar jetën e përditshme në vend. Kushtetuta është ligji më i lartë i vendit, por ka edhe rregulla të tjera që duhet të ndiqen, si ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare, dhe vendimet e Këshillit të Ministrave.

Akti Normativ funksionon në të gjithë vendin dhe ndihmon për të siguruar që të gjitha vendimet të jenë të qarta dhe të ndjekura nga të gjithë.

Akte nënligjore

Akte nënligjore janë rregulla më të deatjuara që miratohen për të zbatuar ligjet, siç janë vendimet e Këshillit të Ministrave apo urdhrat e ministrave. Këto akte duhet të bazohen gjithmonë në ligje dhe nuk mund
të jenë në kundërshtim me to.

Marrëveshjet Ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare janë marrëveshje ku Shqipëria bën pjesë
me vende të tjera ose në organizata ndërkombëtare. Marrëveshjet duhet të miratohen nga Kuvendi për të qenë të vlefshme. Këto marrëveshje bëhen
pjesë e ligjeve të Shqipërisë sapo
publikohen në Fletoren Zyrtare.



Botimi i akteve

Të gjitha rregullat e reja, si ligjet apo vendimet e Këshillit të Ministrave, marrin fuqi pasi publikohen në Fletoren Zyrtare. Kjo mënyrë e botimit siguron që të gjithë qytetarët të jenë në dijeni të rregullave të reja.



PJESA E TETË:
GJYKATA KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese garanton respektimin dhe interpretimin e duhur të Kushtetutës, ligjit më të rëndësishëm të vendit. Ajo ka fuqi të vendosë për mosmarrëveshje që lidhen me Kushtetutën dhe vendimet
e saj janë përfundimtare, ato nuk
mund të ndryshohen.

Vendos nëse ligjet janë në përputhje
me Kushtetutën, gjykon për marrëveshjet ndërkombëtare, vendos për mosmarrëveshje ndërmjet qeverisë dhe institucioneve të tjera, gjykon për veprimtarinë e partive politike dhe mund të vendosë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, nëse
është e nevojshme.

Vendimet që merr Gjykata Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi menjëherë pas botimit.

Gjykata Kushtetuese mund të veprojë pas një kërkese nga disa grupe dhe individë, si Presidenti, Kryeministri, deputetët, Avokati i Popullit, partitë politike dhe qytetarët që mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur.



Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka 9 gjyqtarë. Disa prej tyre emërohen nga Presidenti, disa zgjidhen nga Kuvendi, dhe disa nga Gjykata e Lartë. Secili gjyqtar ka një mandat 9-vjeçar dhe
nuk mund të rrijë në këtë detyrë
më shumë se një herë.

Për të qenë gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duhet të kesh studiuar drejtësi dhe të kesh përvojë të gjatë në fushën ligjore. Gjyqtarët janë të pavarur nga politika.



PJESA E NËNTË: GJYKATAT



Gjykatat janë organet
që vendosin drejtësi.
Ato janë të pavarura
dhe veprojnë sipas
Kushtetutës dhe
ligjeve të vendit.
Gjyqtarët janë të
pavarur dhe nuk mund
të ndikohen nga politika
apo të tjera ndërhyrje.

Ata janë të mbrojtur me ligj dhe kanë
përgjegjësi të veçantë për të siguruar
drejtësi për qytetarët.

Gjykatat përfshijnë Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Ato krijohen për të zgjidhur çështjet që lidhen me shkeljet e ligjit. Përveç këtyre, ka edhe gjykatë të posaçme që merret me veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe me akuzat kundër disa funksionarëve të lartë të shtetit. Gjykatat sigurojnë që ligjet të zbatohen në mënyrë të drejtë e të barabartë për të gjithë.

Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë është një nga gjykatat më të rëndësishme në Shqipëri. Gjyqtarët e saj emërohen nga Presidenti i Republikës dhe kanë një mandat 9-vjeçar. Ata duhet të kenë përvojë të gjatë në drejtësi dhe të jenë juristë të spikatur.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për punën e gjykatave në Shqipëri. Këshilli ka 11 anëtarë. Gjashtë prej tyre janë gjyqtarë që zgjidhen nga gjyqtarët e tjerë, ndërsa pesë të tjerët janë juristë të zgjedhur nga Kuvendi. Këta juristë mund të jenë avokatë, profesorë të drejtësisë, ose përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli i Lartë Gjyqësor emëron gjyqtarë të rinj, vendos rregulla se si duhet të sillen gjyqtarët dhe siguron që këto rregulla të ndiqen. Propozon kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë dhe informon Kuvendin dhe qytetarët për gjykatat në Shqipëri.


PJESA E DHJETË: PROKURORIA

Prokuroria është institucioni shtetëror që përfaqëson
akuzën në gjykatë dhe siguron
që ata që kanë kryer vepra penale
të ndiqen penalisht.

Prokurori i Përgjithshëm

Prokurori i Përgjithshëm drejton prokurorinë. Ai zgjidhet nga Kuvendi dhe është përgjegjës për përfaqësimin e akuzës në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese.





Prokuroria siguron që ligji të respektohet dhe se drejtësia të jetë gjithmonë e pranishme për të gjithë.



Prokuroria e Posaçme është një njësi e veçantë që merret me raste shumë të rëndësishme, si korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Prokurorët

Prokurorët hetojnë krimet dhe paraqesin provat para gjykatës për të vendosur nëse dikush është fajtor apo jo. Prokurorët janë përgjegjës për hetimin e krimeve dhe përgatitjen e rasteve për gjykatë dhe janë të pavarur në punën e tyre. Ata duhet të jenë të ndershëm e të drejtë, duke mos lejuar që asgjë t'i ndikojë në vendimet e tyre.

Kur ndodh një krim, prokurorët janë ata që fillojnë hetimet për të mbledhur prova dhe për të përcaktuar nëse duhet të ngrihet një akuzë kundër dikujt. Ata bashkëpunojnë me policinë dhe organe të tjera për të zbuluar të vërtetën dhe për të siguruar që shkelësit e ligjit të ndëshkohen.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Lartë i Prokurorisë kujdeset për të siguruar që prokurorët në Shqipëri të jenë të pavarur dhe të drejtë në punën e tyre. Këshilli përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë prej tyre janë prokurorë që zgjidhen nga vetë prokurorët e Shqipërisë, ndërsa pesë të tjerët janë juristë të zgjedhur nga Kuvendi. Këta juristë mund të jenë avokatë, profesorë të së drejtës, ose përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli emëron prokurorë të rinj, siguron që ata të ndjekin rregullat dhe propozon kandidatë për Prokuror të Përgjithshëm. Këshilli gjithashtu raporton për punën e prokurorëve dhe informon Kuvendin dhe qytetarët për prokurorinë në Shqipëri.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi siguron që personat që duan të bëhen Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose anëtarë të Gjykatës Kushtetuese janë të kualifikuar dhe të përshtatshëm për këto pozita. Këshilli verifikon nëse kandidatët kanë cilësitë e nevojshme dhe i rendisin ata sipas meritës profesionale.

Këshilli ka 9 anëtarë që përzgjidhen me short çdo vit nga Presidenti i Republikës. Këta anëtarë janë gjyqtarë dhe prokurorë nga gjykatat e ndryshme të Shqipërisë dhe kanë një mandat prej një viti. Kryetari i Këshillit vjen nga Gjykata e Lartë.

PJESA E NJËMBËDHJETË: REFERENDUMI

Referendumi është e drejtë e qytetarëve
për të mbajtur qëndrim për çështje të rëndësishme
duke votuar. Nëse 50 mijë votues dëshirojnë të
shfuqizojnë një ligj,
ata mund të kërkojnë zhvillimin e një referendumi.
Qytetarët mund t'i kërkojnë Presidentit të zhvillojë
referendum për çështje, që ndikojnë jetën e tyre.
Gjithashtu dhe Kuvendi me një të pestën e deputetëve
ose Këshilli i Ministrave mund të vendosin që një
çështje të shtrohet për referendum.




Zhvillimi i referendumit

Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar me referendum. Referendumi zhvillohet vetëm një herë gjatë një viti në një ditë të caktuar nga Presidenti, pasi Gjykata Kushtetuese të ketë dhënë miratimin.



Megjithatë, ka disa çështje shumë të rëndësishme që nuk mund të vendosen përmes një referendumi. Këto përfshijnë: ndryshimet në territorin e Shqipërisë, kufizimin e të drejtave themelore të njeriut, buxheti dhe taksat, deklarimi i luftës
ose paqes, vendosja e gjendjes
së jashtëzakonshme.



PJESA E TREMBËDHJETË:
FINANCAT PUBLIKE

Shteti mbledh para nga taksat dhe tatimet që paguajnë qytetarët. Këto para përdoren për të mbajtur në funksion shumë shërbime të rëndësishme si shkollat, spitalet dhe rrugët. Ndonjëherë, kur ligji e lejon këtë, shteti mund të marrë borxh për të realizuar projekte të mëdha, si ndërtimi i një ure apo një shkolle të re.

Buxheti i shtetit

Buxheti është një plan që tregon se si shteti do të përdorë të ardhurat e mbledhura gjatë një viti. Paratë për të vijnë nga taksat dhe burime të tjera të ligjshme.

Çdo organ i pushtetit qendror dhe vendor tregon publikisht si i përdor paratë dhe çfarë shpenzojnë. Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave paraqesin projektligjin për buxhetin përpara Kuvendit i cili e shqyrton dhe e miraton.

Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë është banka kryesore e shtetit. Ajo është përgjegjëse për nxjerrjen dhe përdorimin e lekut, monedhës shqiptare. Ajo gjithashtu zbaton politikat ekonomike dhe menaxhon rezervat e vendit. Kjo ndihmon që financat e shtetit të jenë të qarta dhe që të përdoren për të mirën e të gjithë qytetarëve. Banka drejtohet nga Guvernatori, i cili zgjidhet nga Kuvendi.

PJESA E KATËRMBËDHJETË: KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni, që kujdeset për mënyrën se si shteti i përdor paratë që mbledh nga taksat dhe që këto para të përdoren si duhet, si për ndërtimin e rrugëve, shkollave dhe spitaleve, për të ndihmuar shtetin dhe qytetarët e tij.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet nga Kuvendi, ai mund të thirret të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, sidomos kur diskutohet për çështjet financiare të rëndësishme për vendin. Kontrollit i Lartë i Shtetit raporton çdo vit në Kuvend.

PJESA E PESËMBËDHJETË:
FORCAT E ARMATOSURA

Të gjithë shqiptarët duhet të mbrojnë
Shqipërinë, kur është e nevojshme.

Nëse dikush nuk dëshiron të mbajë armë për
arsye ndërgjegjeje, ai duhet të kryejë një
shërbim tjetër, që quhet shërbim
alternativ dhe është një mënyrë
për të ndihmuar shtetin.

Presidenti i Republikës është Komandanti
i Përgjithshëm i këtyre forcave.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar këshillon
Presidentin për çështje të sigurisë së vendit.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë
përbëhen nga forcat tokësore,
detare dhe ajrore.

Ushtarakët që shërbejnë nuk mund
të punojnë në qeveri ose të merren me
politikë gjatë kohës që janë në shërbim.
Edhe pse ata shërbejnë për mbrojtjen
e vendit, gëzojnë të drejtat e tyre
kushtetuese si gjithë të tjerët.




PJESA E GJASHTËMBËDHJETË:
MASAT E JASHTËZAKONSHME

Në raste të veçanta, si kur ka luftë, rrezik të madh
ose fatkeqësi natyrore, shteti mund
të marrë masa të jashtëzakonshme.
Këto masa zgjasin vetëm për aq
kohë sa vazhdon rreziku.

Ligjet përcaktojnë se si mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e qytetarëve gjatë këtyre situatave dhe se si shteti do t'i kompensojë për dëmet që mund të pësojnë. Këto masa duhet të jenë të përshtatura me rrezikun
dhe të synojnë kthimin sa më të shpejtë në normalitet. Në raste të tilla, disa ligje dhe vendime nuk mund të ndryshohen dhe nuk mund të bëhen zgjedhje apo referendume.

Në rast se Shqipëria sulmohet ushtarakisht,
Presidenti shpall gjendjen
e luftës. Nëse ka kërcënime të tjera nga jashtë,
Kuvendi vendos për gjendjen e luftës, mobilizimin
dhe përgatitjen
e ushtrisë.

Edhe gjatë periudhave të gjendjeve të tilla, disa nga të drejtat themelore të njeriut nuk mund të kufizohen si e drejta për jetë, ndalimi i torturës apo dhe liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.



PJESA E SHTATËMBËDHJETË: RISHIKIMI I KUSHTETUTËS

Kushtetuta është ligji më i rëndësishëm i një shteti, por ndonjëherë mund të ketë nevojë të ndryshohet. Për të rishikuar Kushtetutën e Shqipërisë, ndryshimi duhet të propozohet nga të paktën një e pesta e deputetëve të Kuvendit dhe për ta miratuar, duhen votat e dy të tretave të deputetëve.

Në disa raste, Kuvendi mund të vendosë që ndryshimet në Kushtetutë të votohen nga populli me referendum. Nëse një e pesta e deputetëve kërkon që ndryshimi të shkojë në referendum, atëherë qytetarët do të votojnë për këtë.


SHKOLLA
BIBLIOTEKA
QENDËR VOTIMESH
BANKA E SHQIPËRISË
BASHKIA
GJYKATA
POLICIA

*Ky botim nuk synon të interpretojë apo të krijojë norma kushtetuese.

Qëllimi i tij është thjeshtimi i terminologjisë dhe koncepteve, në mënyrë që çdo fëmijë të mund të njohë më lehtë Kushtetutën dhe të kuptojë rolin e saj në jetën e qytetarëve.

Kuvendi, 2024



KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
për fëmijë

Kuvendi
Tiranë 2024